



VENDIM
Nr.26 Datë 29.03.2010

MBI KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES HEC I TERVOLIT TE SHOQERISE “HEC I TERVOLIT” SHPK SI BURIM I RINOVUESHEM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “l”, nenit 9 dhe 39, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 9, pikat 1, dhe 2 gërma “a”, të “Rregullores për Proçedurat e Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.03.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC I TERVIOLI” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi kualifikimin e impiantit prodhues HEC i Tervolit të shoqerise “HEC I TERVOLIT” shpk si burim i rinovueshem energjie

Vendosi:

1. Kualifikimin e impiantit prodhues HEC i Tervolit të shoqerise “HEC I TERVOLIT” shpk si burim i rinovueshem energjie.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s

Bujar Nepravishta

Adresa: Blvd "Gjergj Fishta" Nr.10
963
Tirane
69 590
E-mail erealb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22

Tel +355 42

www.ere.gov.al